

**KONFERENCË PËR ANËTARËSIM
NË BASHKIMIN EVROPIAN**

TAKIM POLITIK I KONFERENCËS NDËRQEVERITARE

PËR ANËTARËSIMIN E MAQEDONISË SË VERIUT

NË BASHKIMIT EVROPIAN

QËNDRIMI I PËRBASHKËT I BE-SË

DEKLARATA HYRËSE E BE-SË PËR NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM

1. Në emër të Bashkimit Evropian, kam kënaqësinë t'ju shpreh mirëseardhje përfaqësuesve të nderuar të Maqedonisë së Veriut, për fillimin e **fazës së parë të negociatave për anëtarësimin** e vendit tuaj me Bashkimin Evropian.
2. Ky është një moment historik për të gjithë ne, i cili **shënon një kthesë në evolucionin e marrëdhënieve tona**. Procesi i zgjerimit fuqishëm nxiti reformat politike dhe ekonomike, përforcon paqen, demokracinë dhe stabilitetin në Evropë, si dhe i afron njerëzit.
3. Vendimi për hapjen e negociatave për anëtarësim, në bazë të **metodologjisë së përmirësuar për zgjerim**, të miratuar nga vendet anëtare të Këshillit Evropian në mars të vitit 2020, jo vetëm që paraqet hap të rëndësishëm në marrëdhëniet e Maqedonisë së Veriut me BE-në, por është edhe një tregues i qartë për **mbështetjen e pahamendshme të BE-së për perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor**, i shprehur në agjendën e Selanikut, si dhe në Deklaratat e Sofjes, Zagrebit dhe të Bërdos. Shteti juaj është pjesë e historisë, trashëgimisë dhe kulturës evropiane dhe presim që edhe më tej t'i intensivikojmë lidhjet tona tashmë të mirekrijuara.
4. Hapja e negociatave të anëtarësimit në mënyrë plotësuese tregon se kur plotësohen kushtet, **BE-ja përmbush obligimet e saja**. Siç u demonstrua në konferencën e sotme, Unioni mbetet fuqishëm i përkushtuar në këtë proces. Përshëndesim vendosmërinë e Maqedonisë së Veriut për tu avancuar në agjendën e reformave të BE-së dhe presim përkushtim të vazhdueshëm politik për implementim thelbësor dhe intensiv të reformave të domosdoshme.
5. Maqedonia e Veriut – vend kandidat për anëtarësim që nga viti 2005 – është partner i ngushtë i Bashkimit Evropian si pjesë e **Procesit të Stabilizim-Asociimit**. Marrëveshja jonë për Stabilizim-Asociim (MSA), e para në rajon, është në fuqi që nga viti 2004 dhe paraqet bazë për bashkëpunimin tonë të gjerë në një sërë fushash. Maqedonia e Veriut vazhdon t'i zbatojë detyrimet e saja sipas MSA-së. Dialogu ynë politik dhe ekonomik zhvillohej kryesisht në kuadër të organeve të MSA-së.
6. **Përfitimet për të dy palët nga marrëdhëniet tona të ngushta janë të dukshme**. BE-ja është partneri juaj më i madh tregtar, me përfitime të dukshme për biznesin dhe investimet e huaja. Për qytetarët tuaj, udhëtimi në BE është lehtësuar me liberalizimin e vizave të hyrë në fuqi në vitin 2009. BE-ja siguron mbështetje financiare dhe teknike, në kuadër të instrumenteve të ndryshme financiare, dhe do të vazhdojë të sigurojë ndihmë të këtillë, në kuadër të Instrumentit për Ndihmë Para-aderuese. Për më tepër, Maqedonia e Veriut merr pjesë në një numër të

caktuar programesh të BE-së, siç janë: Erasmus+, Evropa Kreative, Programi për Konkurrencë të Ndërmarrjeve, Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (COSME) dhe Evropa për qytetarët. Maqedonia e Veriut gjithashtu është monitorues në Agjencinë për të Drejtat Themelore dhe palë e marrëveshjes së Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Traktatit të Komunitetit të Transportit.

7. Fuqia e marrëdhënieve tona - uniteti dhe solidariteti ynë - është demonstruar edhe një herë gjatë **krizës së KOVID-19**. Bashkimi Evropian mbështeti Maqedoninë e Veriut dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor. Kjo mbështetje si dhe bashkëpunimi, ishin shumë më tepër se cilado mbështetje e ofruar për rajonin nga partner tjerë, me ndihmë prej rreth 66 milionë euro, në formë të grantit dhe 160 milionë euro për ndihmë makrofinanciare për Maqedoninë e Veriut¹. Bashkimi Evropian gjithashtu njeh mbështetjen e vlefshme që Ballkani Perëndimor ka siguruar gjatë pandemisë për fqinjët e tyre dhe për BE-në. Kjo pasqyron solidaritetin dhe mbështetjen e ndërsjellë mbi të cilat është ndërtuar BE-ja. **Agresioni ushtarak i pajustificuar dhe i paprovokuar i Ruisë ndaj Ukrainës**, ka ndikim të madh në të gjithë kontinentin Evropian. Nga vendet e Ballkani Perëndimor pritet që të obligohen ndaj vlerave Evropiane, si vende të ardhshme anëtare të BE-së. BE-ja dhe Ballkani Perëndimor tashmë i kanë bashkuar forcat për mbështetje të Ukrainës dhe luftën kundër fushatës Ruse për dezinformata. Posaçërisht e përshëndesim harmonizimin e plotë të Maqedonisë së Veriut me të gjitha vendimet dhe deklaratat e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së (PPJS) dhe inkurajojmë Maqedoninë e Veriut të vazhdojë me harmonizimin e plotë me PPJS të BE-së.
8. Këshilli, në konkluzionet e tij të 25 marsit 2020, të cilat u miratuan nga anëtarët e Këshillit Evropian më 26 mars 2020, e përshëndeti vendosmërinë e Maqedonisë së Veriut **për avancimin e agjendës së reformave të BE-së**, dhe të dhënies së rezultateve të dukshme dhe të qëndrueshme, njëherit duke i përmbushur kushtet e përcaktuara nga Këshilli në qershor të viti 2018 për hapjen e negociatave të anëtarësimit.
9. Negociatat tona bazohen në **nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian** dhe i marrin parasysh të gjitha konkluzionet relevante të Këshillit, e veçanërisht ato të marsit të vitit 2020, me të cilat miratohet Metodologjia e përmirësuar për zgjerim, konsensusi i ripërtërirë për zgjerim i caktuar nga ana e Këshillit Evropian, në dhjetor të vitit 2006, dhe konkluzionet e Këshillit Evropian të Kopenhagës në vitin 1993.

¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2022-06/23.06.2022-factograph_north_macedonia.pdf

Këshilli mbetet fuqishëm i vendosur për avancimin e procesit të zgjerimit, në bazë të parimeve dhe konkluzioneve të përcaktuara, me çka integrohet metodologjia e përmirësuar, gjë që procesin e anëtarësimit e bën **më të parashikueshëm, më kredibil, më dinamik dhe merr drejtëm më të fuqishëm politik**, duke u bazuar në kriteret objektive dhe në kushtëzimet rigorozë pozitive dhe negative dhe në reverzibilitet.

BE-ja vazhdon t'i kushtojë rëndësi të madhe zbatimit koherent të **konsensusit të ripërtërirë për zgjerim**, i cili bazohet në konsolidimin e angazhimeve, kushtëzimin objektiv dhe rigoroz, komunikimin më të mirë, së bashku me kapacitetin e BE-së në të gjitha dimensionet, për integrimin e anëtarëve të rinj, ku secili vend vlerësohet sipas meritave të veta.

10. Në përputhje me konkluzionet e Këshillit, të datës 25 mars 2020, të miratuara nga anëtarët e Këshillit Evropian më 26 mars 2020, Këshilli [miratoi] një **Kornizë të Negociatave të Përgjithshme**, duke marrë parasysh konkluzionet e lartpërmendura, si dhe konkluzionet e tjera relevante të Këshillit, konsensusin e ripërtërirë për zgjerim dhe praktikën e vendosur.
11. Këtë kornizë negociuese do t'ua prezantojmë në bazë të qëndrimit të përgjithshëm të BE-së, gjatë takimit të radhës së konferencës ndërqeveritare, të cilën jemi të gatshëm ta mbajmë pa vonesa të mëtejshme apo pa ndonjë vendim plotësues politik, menjëherë sapo Maqedonia e Veriut ta zbatojë zotimin për përfundimin e ndryshimeve kushtetuese, ashtu siç është theksuar në konkluzionin e Këshillit të datës XX/XX/2022, në përputhje me procedurat e veta të brendshme.
12. Do t'ju prezantojmë gjithashtu se çfarë përfshin e drejta e BE-së "*acquis*".
13. Në këtë këndvështrim, Këshilli vlerëson se Komisioni ka avancuar punën e tij për të realizuar dhe përfunduar procesin e shqyrtimit analitik të së drejtës së BE-së *acquis*, dhe është i gatshëm që në kohë t'ia prezantojë rezultatet Maqedonisë së Veriut. Bazuar në këtë, e fton Komisionin që të vazhdojë ta vlerësojë shkallën e gatishmërisë së Maqedonisë së Veriut për hapje të negociatave në fusha konkrete, dhe t'i identifikojë çështjet që me shumë gjasa do të shfaqen gjatë negociatave, duke filluar nga klasteri i vlerave fundamentale, i cili, në përputhje me Kornizën Negociuese, do të hapet i pari, pasi që Maqedonia e Veriut do t'i plotësojë kriteret relevante të dakorduara nga Këshilli.
14. **Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** mbesin elementet themelore të procesit të zgjerimit. Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë të angazhohet në mënyrë konstruktive për bashkëpunim inkluziv rajonal dhe t'i forcojë marrëdhëniet me vendet fqinje. Sot, kujtojmë rëndësinë e arritjes së rezultateve të dukshme dhe zbatimin e marrëveshjeve

bilaterale me vullnet të mirë, duke përfshirë Marrëveshjen e Prespës me Greqinë dhe Marrëveshjen për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore me Bullgarinë.

Në këtë drejtim, e përshëndesim marrëveshjen për protokollin nga takimi i dytë i Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar të formuar në përputhje me nenin 12 të kësaj marrëveshjeje. Ky hap i rëndësishëm do të kontribuojë në marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal, të cilat mbeten elemente thelbësore të procesit të zgjerimit, si dhe të procesit të Stabilizim-Asociimit.

15. Në periudhën deri në anëtarësim, Maqedonia e Veriut në mënyrë **progresive do të duhet t'i harmonizojë** politikat e veta ndaj vendeve të treta, dhe qëndrimet e saja në kuadër të organizatave ndërkombëtare, me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të saja.
16. Të kujtojmë gjithashtu se paralelisht me negociatat për anëtarësim, Unioni dhe Maqedonia e Veriut do të vazhdojnë me **dialogun e tyre me shoqërinë civile dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës**, me qëllim të afrimit të njerëzve dhe sigurimit të mbështetjes së qytetarëve për procesin e anëtarësimit. Presim që Maqedonia e Veriut para publiku të saj, t'i komunikojë me precizitet dhe në mënyrë strategjike, përfitimet dhe detyrimet nga procesi i anëtarësimit, duke përfshirë edhe ballafaqimin me dezinformatat, në përputhje me përcaktimin e saj strategjik pro-Evropian.
17. U mbetet vendeve anëtare të vendosin se a janë kushtet e përshtatshme për përfundimin e negociatave, duke pasur parasysh zhvillimet e së drejtës së BE-së *acquis* nga data e hapjes së negociatave dhe gatishmëria e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim.
18. Negociatat e anëtarësimit që i fillojmë sot do të jenë rigorozë dhe që kërkojnë shumë mund. Me vendosmëri dhe përkushtim, jemi të bindur në kapacitetin tuaj që do t'i sillni ato deri në përfundim të suksesshëm. Do t'ju mbështesim në përpjekjet tuaja dhe me padurim presim t'ju shprehim mirëseardhje si anëtar fuqiptotë i Bashkimit Evropian.